



Instalimi i shërbimit COBISS DGW



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization

Regional Centre for
Library Information Systems and
Current Research Information Systems
Regionalni center za knjižnične
informacijske sisteme in informacijske
sisteme o raziskovalni dejavnosti



© IZUM, 2023

IZUM, COBISS, COMARC, COBIB, COLIB, CONOR, SICRIS, E-CRIS, COBISS3, mCOBISS, COBISS+, dCOBISS janë marka të regjistruara në pronësi të institucionit publik IZUM.

PËRMBAJTJA

1	Hyrje	1
2	Instalimi i shërbimit COBISS DGW	1
3	Vendosja e emrit të përdoruesit të domenit.....	6
4	Instalimi i USB-driverit për RFID-libra.....	8
5	Instalimi i driverit të pajisjes RFID për leximin e kartave të anëtarësisë	8
6	Shërbimi COBISS DGW	8
	Shërbimi COBISS DGW	8
	Përshkrimi i dritares në internet Manage Local Devices.....	10
	Rregullimi i parametrave në Manage Local Devices	10
	Përshkrimi i dritares në internet Common List RFID items.....	12
	Përshkrimi i dritares në internet RFID Book List.....	13
	Përshkrimi i dritares në internet RFID Book Editor.....	14
	Përshkrimi i dritares së internetit RFID Patron Editor	14
	Përshkrimi i parametrave për konfigurimin e shërbimit COBISS DGW	15
	Skedarët e evidencës për COBISS DGW	15
7	Njoftimi i IZUM-it dhe konfirmimi i funksionimit.....	15
8	Konfigurimi i lexuesve RFID për zgjidhjet e IZUM-it për përdorimin në COBISS3	16
	Kontrollimi i shpejtë i funksionimit të pajisjeve RFID për materialin në COBISS3	18

FIGURAT

Figura 1: Dritarja fillestare e instalimit.....	1
Figura 2: Përzgjedhja e vendit të instalimit në kompjuter	2
Figura 3: Konfirmimi i instalimit.....	2
Figura 4: Përfundimi i instalimit.....	3
Figura 5: Instalimi i <i>Setup DGW</i>	3
Figura 6: Krijimi i dosjes Cobiss3Files.....	3
Figura 7: Njoftimet gjatë instalimit të Cobiss3Files	4
Figura 8: Vendosja e akronimit të bibliotekës	4
Figura 9: Përfundimi i procedurës së instalimit	5
Figura 10: Problemet gjatë instalimit.....	5
Figura 11: Parametrat e ndryshores JAVA_HOME	5
Figura 12: Dritarja Services	6
Figura 13: Shënimi i përdoruesit të domenit.....	7
Figura 14: Riaktivizimi i <i>Cobis3JettyService</i>	7
Figura 15: Shërbimi COBISS DGW	9
Figura 16: Dritarja Manage Local Devices	10
Figura 17: Parametrat e pajisjeve.....	11
Figura 18: Parametrat e pllakës RFID për materialet e lidhura përmes USB	11
Figura 19: Parametrat e lidhjes TCP/IP të pllakës RFID për materialin – driveri.....	12
Figura 20: Parametrat e lidhjes TCP/IP të pllakës RFID për materialin – COBISS DGW	12
Figura 21: Dritarja për shfaqjen e listës së materialeve në pllakën RFID për materialet	13
Figura 22: Dritarja për shfaqjen e listës së materialeve në pllakën RFID për materialin.....	13
Figura 23: Dritarja RFID Book Editor (materiali)	14
Figura 24: Dritarja RFID Patron Editor	14
Figura 25: Metoda Parametrat e pajisjeve RFID	16
Figura 26: Dritarja për konfigurimin e pajisjeve RFID - aktivizimi.....	16
Figura 27: Dritarja për konfigurimin e pajisjeve RFID - deaktivizimi	17
Figura 28: Metoda Pajisja RFID /statusi i mbrojtjes.....	18
Figura 29: Paneli i kontrollit RFID	18

TABELAT

Tabela 1: Parametrat e ndryshores JAVA_HOME	6
---	---

1 Hyrje

Në këtë dokument është përshkruar procedura e instalimit dhe e rregullimit të shërbimit COBISS DGW, i cili është në dispozicion vetëm për sistemin operativ Windows. Ky shërbim është i nevojshëm për funksionimin e pajisjeve RFID, ndërsa në COBISS Lib për funksionimin e shumicës së pajisjeve periferike (p.sh. printerët, arkat etj.) dhe disa funksione të tjera siç është instalimi i certifikatit për sirtarin e arkës, VALÚ etj.

Inventarizimi për RFID është përshkruar në udhëzime të ndara.

Regjistrimi i të dhënave në çipin RFID është rregulluar sipas standardit danez: http://biblstandard.dk/rfid/dk/rfid_data_model_for_libraries_february_2009.pdf.

Metoda përdoret vetëm për nevojat e IZUM-it për mbështetjen e RFID.

SHËNIM: Për instalimin e shërbimit COBISS DGW fillimisht duhet të instalohet programi Java me kod të hapur, versioni pa pagesë. Më shumë informacione rreth instalimit të Javas mund të gjeni në udhëzimet: https://www.cobiss.net/doc/Namescanje_OpenJDK_8%E2%80%93x64_windows_EN.pdf

2 Instalimi i shërbimit COBISS DGW

Për instalimin e shërbimit në kompjuter nevojiten të drejtat e administratorit. Programin instalues C3Setup për Windows 64-bit e transferoni nga faqja elektronike <https://www.cobiss.si/priporocena-oprema/doc/c3dgw/lastversion/Adm64/C3Setup.msi>.

Kur të filloni instalimin hapet dritarja si më poshtë, në të cilën duhet të klikoni **Next**.




Figura 1: Dritarja fillestare e instalimit

Instalimin e vazhdoni duke klikuar butonin **Next**.




Figura 2: Përzgjedhja e vendit të instalimit në kompjuter

Klikoni butonin **Next**, përmes të cilit filloni kopjimin e të dhënave dhe startoni shërbimin.




Figura 3: Konfirmimi i instalimit

Instalimin e përfundoni duke klikuar në butonin **Close**.




Figura 4: Përfundimi i instalimit

Pasi përfundimit të instalimit në desktop gjeni programin *Setup DGW* dhe filloni instalimin e tij.



Figura 5: Instalimi i *Setup DGW*

Hapet dritarja në vazhdim, në të cilën klikoni butonin **OK**. Përmes butonit **OK** konfirmoni edhe dritaret në vazhdim.




Figura 6: Krijimi i dosjes Cobiss3Files




Figura 7: Njoftimet gjatë instalimit të Cobiss3Files

Duke klikuar në kutinë e zgjedhjes përzgjidhni mundësinë *Install service for Cobiss devices* dhe shënoni akronimin e bibliotekës tuaj (p.sh. BASH). Konfirmoni duke klikuar në butonin **Setup**.




Figura 8: Vendosja e akronimit të bibliotekës

Hapet dritarja në vazhdim në të cilën duhet të klikoni butonin **OK**.




Figura 9: Përfundimi i procedurës së instalimit

Problemet gjatë instalimit të programit

Nëse nuk keni përcaktuar ndryshoren JAVA_HOME, programi ju njofton për këtë dhe instalimi përfundon para kohe.




Figura 10: Problemet gjatë instalimit

Ndryshoren JAVA_HOME e përcaktoni në mjediset e ndryshoreve të sistemit.




Figura 11: Parametrat e ndryshores JAVA_HOME

Emri i ndryshores është JAVA_HOME (shkronja kapitale). Vlera e ndryshores varet nga lloji dhe versioni i programit Java.

Lloji i programit Java	Emri i ndryshores	Vlera
AdoptOpenJDK	JAVA_HOME	C:\ProgramFiles\AdoptOpenJDK\jdk-8.0.xxx.x-hotspot\
Eclipse Adoptium	JAVA_HOME	C:\Program Files\Eclipse Adoptium\jdk-8.0.xxx.x-hotspot\
Licenčna Oracle Java	JAVA_HOME	C:\Program Files\Java\jre1.8.0_xxx
OpenWebStart	JAVA_HOME	C:\Program Files\OpenWebStart\jre

Tabela 1: Parametrat e ndryshores JAVA_HOME

SHËNIM: Nëse shërbimi tashmë është instaluar, ndërsa ju aktivizoni programin për instalim dhe përzgjidhni funksionin *Repair*, fillimisht duhet të ndaloni *Cobiss3JettyService*.

3 Vendosja e emrit të përdoruesit të domenit

Nëse përdorni printerët në rrjet ose serverin për printim, për të hyrë në *Cobiss3JettyService* duhet të përdorni emrin e përdoruesit të domenit dhe fjalëkalimin. Në sistemin Windows gjeni *Services* dhe ato i aktivizoni nëse keni autorizimet e administratorit. Më pas gjeni shërbimin *Cobiss3JettyService* hapni listën duke klikuar me tastin e djathtë të miut dhe përzgjidhni *Properties*:




Figura 12: Dritarja Services

Në dritaren *Cobis3JettyService Properties* përzgjidhni skedën *Log On*, përzgjidhni mundësinë *This account* dhe shënoni emrin e përdoruesit të domenit dhe fjalëkalimin. Emri i përdoruesit të domenit duhet të shënohet në formën <domeni>\<emri i përdoruesit> p.sh.

domenitestues\printerët. Pas shënimit të emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit klikoni **Apply** dhe **OK**.




Figura 13: Shënimi i përdoruesit të domenit

Ju rekomandojmë, që për nevojat e printimit të krijohet emri i përdoruesit me vlefshmëri të gjatë të fjalëkalimit, sepse fjalëkalimi duhet të ndryshohet sa herë që ndryshon fjalëkalimi për përdoruesin e domenit.

Pas ndryshimit të përdoruesit, *Cobis3JettyService Properties* aktivizojeni sërish:




Figura 14: Riaktivizimi i Cobis3JettyService

4 Instalimi i USB-driverit për RFID-libra

Në dosjen *C:\Cobiss3Files\bin* ndodhet dosja *Standard_USB_Driver_v03.10.00*, në të cilën janë udhëzimet për instalimin e USB-driverit. Instalimi i driverit fillon me aktivizimin e skedarit *setup.exe*. Guida ju udhëzon gjatë gjithë procedurës së instalimit.

Mund të përdorni edhe driverat e fundit, të cilët i merrni nga faqja elektronike FEIG ose ata vinë bashkë me pajisjen.

5 Instalimi i driverit të pajisjes RFID për leximin e kartave të anëtarësisë

Në dosjen *C:\Cobiss3Files\bin* ndodhet dosja *Setup_CDC_V184_Build20130214*, në të cilën janë udhëzimet për instalimin e USB-driverit CDC për ndërfaqen FEIG ID RW40.30-USB. Instalimi bëhet duke aktivizuar skedarin *setup.exe*. Guida për instalim ju udhëzon gjatë gjithë procedurës së instalimit.

Mund të përdorni edhe driverat e fundit, të cilët i merrni nga faqja elektronike FEIG ose ata vinë bashkë me pajisjen.

6 Shërbimi COBISS DGW

Shërbimi COBISS DGW është program i pavarur, në Java, i cili kujdeset për komunikimin me pajisjet periferike. COBISS3 dhe COBISS Lib përmes shërbimeve në internet lidhen me ndërfaqen COBISS dhe në këtë mënyrë përmes shërbimit COBISS DGW mundësohet qasja në pajisjet periferike. Shërbimi instalohet në çdo kompjuter, në të cilin instalohet COBISS3 apo COBISS Lib.

Shërbimi është i orientuar në internet, që do të thotë se shërbimi në tërësi është i disponueshëm përmes shfletuesit të internetit. Mund të përdorni cilindo shfletues, mirëpo rekomandohet Mozilla Firefox.

Programi përdoret kryesisht nga personeli teknik.

Shërbimi COBISS DGW

Shërbimin COBISS DGW e gjeni përmes shfletuesit të internetit në URL-në: <http://localhost:8088/c3dgw/>. Në këtë URL paraqitet faqja bazë:




Figura 15: Shërbimi COBISS DGW

- **COBISS DGW Properties:** Shfaqen të dhënat për parametrat bazë RFID dhe serverin DMS. Parametrat rregullohen në skedarin *Dgw.cfg* në dosjen *C:\Cobiss3Files\conf*.
- **COBISS DGW SIP Properties:** Shfaqen parametrat për serverin SIP, të cilin e përdorin libromatët, klasifikuesit etj. Të dhënat përdoren për lidhjen e sigurt VPN. Parametrat rregullohen në skedarin *Dgw.cfg* në dosjen *C:\Cobiss3Files\conf*. Butoni **Manual Run** shërben për aktivizimin manual të komandës PLINK. Ndërsa butoni **Test SIP2** verifikon nëse është ndërtuar lidhja SIP. Pas testit të suksesshëm shfaqet njoftimi *loginresponse false*. Butoni **Check Plink Process** verifikon nëse në sfond vazhdon procesi Plink.exe. **Kill Plink Process** ndërpret procedin e caktuar *Plink.exe*.
- **Manage Local Devices:** Me këtë metodë hapet dritarja për parametrat e pajisjeve të veçanta periferike, siç është lexuesi RFID për materialet, lexuesi RFID për anëtarët etj.
- **RFID Book Common List:** Shfaqen të gjithë çipat RFID, të cilët ndodhen në lexuesin RFID për materialin. Shfaqet edhe tek metodat e ndryshme nga COBISS Lib, ku mbrojtja e materialit duhet të bëhet në mënyrë manuale.
- **RFID Book List:** Shfaqen të gjithë çipat RFID, të cilët ndodhen në lexuesin RFID për materialet. Përdoret vetëm tek driveri i IZUM-it.
- **RFID Book Editor:** Mund të shënoni dhe redaktoni të dhënat në çipin RFID për materialet. Përdoret vetëm tek driveri i IZUM-it.
- **RFID Patron Editor:** Shfaqen të dhënat e regjistruara në çipin RFID të kartës së anëtarit.
- **RFID REST Interface:** Butoni është aktiv nëse ekzistojnë parametrat përkatës, të cilët i përdorin zhvilluesit e programit në pajisjet periferike.
- **Edit TaxSI:** Është metoda për rregullimin e parametrave për konfirmimin tatimor të faturave në Republikën e Sllovenisë.

- **Edit Valu:** Përmes kësaj metode rregullohen parametrat dhe përdoret vetëm në Republikën e Sllovenisë.
- **Edit TaxSR:** Është metoda për rregullimin e parametrave për konfirmimin tatimor të faturave dhe përdoret vetëm në Republikën e Serbisë.

Përshkrimi i dritares në internet Manage Local Devices

Në dritaren **Manage Local Devices** rregullohen parametrat për driverat. Për momentin duhet të rregulloni tri ndërfaqe fizike: *RFID_book* – lexuesi i kartave për materialet, *RFID_card* – lexuesi i kartave për anëtarët, *POS* – POS-terminal, *Sign_tablet* – tabela për nënshkrim.




Figura 16: Dritarja Manage Local Devices

Rregullimi i parametrave në Manage Local Devices

Për shtimin e pajisjes së re RFID në kompjuter duhet të rregulloni parametrat. Tek **Manage local devices** duhet të përzgjidhni pajisjen për të cilën dëshironi të rregulloni parametrat dhe klikoni **Edit**.




Figura 17: Parametrat e pajisjeve

Tek **Device properties** përzgjidhni **Enabled: Yes**. Nëse përdorni zgjidhjet e IZUM-it për materialet, tek **Type/Model** përzgjidhni: **IzumHoldingFeigReader**. Për mënyrën e lidhjes mund të përzgjidhni midis USB, TCP/IP ose Serial.




Figura 18: Parametrat e pllakës RFID për materialet e lidhura përmes USB

Nëse përzgjidhni TCP/IP, në dosjen *C:\Cobiss3Files\bin\VO.9.0* keni programin *FEDiscO.exe*, përmes të cilit mund të verifikoni IP-adresën e pajisjeve RFID. Këtë IP-adresë më pas e shënoni në fushën Address.




Figura 19: Parametrat e lidhjes TCP/IP të pllakës RFID për materialin – driveri





Figura 20: Parametrat e lidhjes TCP/IP të pllakës RFID për materialin – COBISS DGW

Përshkrimi i dritares në internet Common List RFID items

Në dritaren **Common List RFID items** mund të lexoni çipat RFID, të cilët ndodhen në pllakën RFID për materialin. Këtë dritare që përdoret tek COBISS Lib, në COBISS3 e zëvendëson dritarja **RFID-panelet i kontrollit** (metoda **RFID-pajisja/statusi i mbrojtjes**). Leximi i etiketave RFID do të funksionoj pas konfirmimit të pajisjeve në IZUM (shih kap. 6). Në këtë mënyrë mund të aktivizoni/çaktivizoni mbrojtjen e materialit në kolonën **EAS tag**.




No.	Inventory number	EAS tag
1	10041866,1-7	Enabled
2	00417881	Enabled
3	10040434	Enabled

Figura 21: Dritarja për shfaqjen e listës së materialeve në pllakën RFID për materialet

Përshkrimi i dritares në internet RFID Book List

Në dritaren **List RFID items** mund të lexoni çipat RFID, të cilët ndodhen në pllakën RFID për materialet. Rezultatet shfaqen në formatin danez S24/u4 ('mandatory part'). Dritarja është aktive vetëm për nevojat e IZUM-it. Leximi i etiketave RFID funksionon pas konfirmimit të pajisjes në IZUM (shih kap. 6). Në kolonën **EAS tag** mund të aktivizoni/çaktivizoni mbrojtjen e materialit.



RFID tag (UID)	Inventory number	Parts	Part	Library code (SIGLA)	Country code	EAS tag
E004015068BB33EA	10041866,1-7	1	1	50550	SI	Enabled
E004015068BB3641	10039408,12	1	1	50550	SI	Enabled
E004015068BB376D	00241609	1	1	50550	SI	Enabled
E004015068BB5367	00412226	2	2	50550	SI	Enabled
E004015068BB5488	00417881	1	1	50550	SI	Enabled
E004015068BB5A31	10040434	1	1	50550	SI	Enabled
E00401506C504C33	00412226	2	1	50550	SI	Enabled

Figura 22: Dritarja për shfaqjen e listës së materialeve në pllakën RFID për materialin

Përshkrimi i dritares në internet RFID Book Editor

Në dritaren **RFID Book Editor** mund të lexoni dhe të shënoni të dhënat në çipin RFID për materialet. Të gjitha të dhënat regjistrohen në formatin danez S24/u4 ('mandatory part'). Dritarja është aktive vetëm për zgjidhjet e IZUM-it. Dritarja nuk përdoret për inventarizim ose për funksione të tjera, mirëpo vetëm për qëllime testuese.




Figura 23: Dritarja RFID Book Editor (materiali)

Përshkrimi i dritares së internetit RFID Patron Editor

Në dritaren **RFID Patron Editor** mund të lexoni të dhënat në çipin RFID për kartën e anëtarësisë.




Figura 24: Dritarja RFID Patron Editor

Përshkrimi i parametrave për konfigurimin e shërbimit COBISS DGW

Në dosjen *C:\Cobiss3Files\conf* është skedari *Dgw.cfg*. Në të ndodhen parametrat, të cilët janë të rëndësishëm për konfigurimin e shërbimit COBISS DGW.

Parametrat:

- **PERIOD_DGW** – me këtë parametër përcaktoni intervalin e dërgimit të njoftimeve në server. Njësia bazë është sekondi. Vlera e paracaktuar është *900* (sekonda).
- **LOGGING_LEVEL** – vlera duhet të jetë *ALL*, përcakton nivelin e regjistrimit.
- **ACRONYM_DGW** – shënohet akronimi i bibliotekës. Është e dhënë shumë e rëndësishme.
- **DMS_SERVER_ADDRESS** – shënohet adresa e serverit dms. Vlera e paracaktuar është *ws.cobiss.net*.
- **DMS_SERVER_PORT** – porti, në të cilin dëgjon serveri dms. Vlera e paracaktuar është *443*.
- **DMS_SERVER_SSL** – vlera duhet të jetë *true*.

Serveri *dms* regjistron dhe shfaq statusin e shërbimit *dgw*. Shërbimi *dgw* lidhet me serverin *dms*, ku regjistrohet gjendja e shërbimit *dgw*. Në këtë mënyrë monitorohet më lehtë funksionimi i ndërfaqeve periferike.

Skedarët e evidencës për COBISS DGW

Në dosjen *C:\Cobiss3Files\log* ndodhen skedarët e evidencës (ang. log files) për COBISS DGW. Në këta skedarë mund të vëzhgoni funksionimin e COBISS DGW në tërësi.

7 Njoftimi i IZUM-it dhe konfirmimi i funksionimit

Për funksionimin e duhur të pajisjes RFID në COBISS3 fillimisht pajisjen duhet ta konfirmoni në IZUM. Këtë e bëni duke thirrur në numrin e telefonit **+355 (0)68 200 15 49 / +383 (0)43 509 419** ose përmes adresës elektronike sherbimi@al.cobiss.net / sherbimi@ks.cobiss.net. Ju do të njoftoheni kur funksionimi i pajisjes RFID të mundësohet.

8 Konfigurimi i lexuesve RFID për zgjidhjet e IZUM-it për përdorimin në COBISS3

Nëse përdorni pajisjet RFID, të cilat mbështesin zgjidhjet e IZUM-it dhe këto zgjidhje i përdorni, parametrat në COBISS3 i rregulloni sipas kësaj procedure.

Përzgjidhni metodën **Sistemi / Parametrat / Parametrat e pajisjeve RFID**.




Figura 25: Metoda Parametrat e pajisjeve RFID

Hapet dritarja **Parametrat e pajisjeve RFID**. Në kompjuterët, në të cilët është e lidhur pajisja RFID për materialin, përzgjidhni vlerën *TRUE* tek mundësia *HAS RFID TERMINAL* dhe vlerën *IzumC3DGW* tek mundësia *RFID TERMINAL TYPE*. Nëse përdorni edhe lexuesin e rekomanduar për kartelat RFID për anëtarët, përzgjidhni vlerën *TRUE* tek mundësia *HAS Card RFID TERMINAL* dhe vlerën *IzumC3DGW* tek mundësia *Card RFID TERMINAL TYPE*.




Figura 26: Dritarja për konfigurimin e pajisjeve RFID - aktivizimi

SHËNIM: Kompjuterët apo pajisjet e tjera të punës në bibliotekë që nuk kanë të lidhur një pajisje RFID, tek pajisja përkatëse duhet të jetë vlera *FALSE*. Në këtë mënyrë sigurohet funksionim më i shpejtë i programit COBISS3.




Figura 27: Dritarja për konfigurimin e pajisjeve RFID - deaktivizimi

Personeli teknik i aftësuar mund të bëjë konfigurimin përkatës të pajisjeve RFID në skedarin *RFIDTerminalParameters.txt*, i cili ndodhet në dosjen *C:\Cobiss3Files*. Skedarin me parametrat e duhur më pas mund ta shpërndani në të gjithë kompjuterët, në të cilët pajisja RFID është e lidhur. Parametrat e pajisjes RFID për materialin që përdor zgjidhjet e IZUM-it është:

```
RFIDTERMINAL_hasRFIDTerminal#true
RFIDTERMINAL_RFIDTerminalType#9
RFIDTERMINAL_hasCardRFIDTerminal#true
RFIDTERMINAL_CardRFIDTerminalType#1
```

Vlerat e parametrave të veçantë janë këto:

- **RFIDTERMINAL_hasRFIDTerminal**
 - *true* – pajisja për materialin është e lidhur me kompjuterin apo pajisjen tjetër
 - *false* – pajisja për materialin nuk është e lidhur me kompjuterin apo pajisjen tjetër
- **RFIDTERMINAL_RFIDTerminalType**
 - *9* – IzumC3DGW (zgjidhja e IZUM-it)
- **RFIDTERMINAL_hasCardRFIDTerminal**
 - *true* – pajisja për kartën e anëtarësisë është e lidhur me kompjuterin apo pajisjen tjetër
 - *false* – pajisja për kartën e anëtarësisë nuk është e lidhur me kompjuterin apo pajisjen tjetër
- **RFIDTERMINAL_CardRFIDTerminalType**
 - *1* – IzumC3DGW (zgjidhja e IZUM-it)

Kontrollimi i shpejtë i funksionimit të pajisjeve RFID për materialin në COBISS3

Në pajisjen RFID vendosni materialin me çipin RFID të regjistruar në mënyrën e duhur. Përzgjidhni metodën **Sistemi / Pajisja RFID /statusi i mbrojtjes**.




Figura 28: Metoda Pajisja RFID /statusi i mbrojtjes

Hapet dritarja **RFID-paneli i kontrollit**, ku shifet qartë statusi i pajisjes RFID.




Figura 29: Paneli i kontrollit RFID

Nëse pajisja RFID nuk është e lidhur saktë, shfaqet njoftimi »Pajisja RFID nuk është në dispozicion.« ose »RFID-Instanca RFID nuk ekziston.«. Në këtë rast duhet të verifikoni nëse janë të rregulluar të gjithë parametrat e nevojshëm për pajisjen RFID dhe nëse pajisja është e lidhur me burimin apo rrjetin. Arsyeja e problemeve mund të jetë edhe fakti, se në kompjuterin tuaj duhet të aktivizohet shërbimi **Cobiss3JettyService**.

SHËNIM: Pas çdo ndryshimi të parametrave të pajisjes RFID nevojitet lidhje e sërishme me COBISS3.